ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL VITI**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **657-25-1780-1-1-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizimi me barna për nevojat e QKMF-s**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**MESE PHARM SH.P.K.**
NUI	**812217421**
Adresa	**Magjistralja Prishtine-Podujeve, pn**
Vendi	**Prishtine**
Kodi postar	**10000**
Numri Telefonit	**+38344122204**
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**Valdet Jupolli**
Adresa elektronike	**mesepharm@gmail.com**
Data e parashtrimit të ankesës	**22.04.2025**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Furnizimi me barna për nevojat e QKMF-s

Data e njoftimit për kontratë: 12.03.2025

Data e fundit për dorëzimin e ofertave: 22.04.2025

Kërkesa për rishqyrtim: 16.04.2025

Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim 22.04.2025 ora 11:20

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ ***Jo*** ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Kerkese per rishqyrtim

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së

Neni 7 i LPP-së
Neni 27 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së
Neni 17 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik
Neni 25 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Data e njoftimit për kontratë është bërë me dt.12.03.2025, kurse hapja e ofertave është parashikuar të bëhet me dt. 22.04.2025.

Ne kemi analizuar dosjen e tenderit dhe pas analizës që kemi bërë, kemi vërejtur se autoriteti kontraktues ka përgatitur dosjen e tenderit në kundërshtim me nenin 27 të LPP-së, për faktin se janë vendosur disa kërkesa diskriminuese/favorizuese, të cilat do ti sqarojmë më poshtë:

Ne me dt. 02.04.2025 kemi parashtruar kërkesë për informacione shtesë, ndërsa deri me datën 15.04.2025 nuk kemi pranuar përgjigje nga ana e AK-së sa i përket pyetjeve tona. Andaj përderisa nuk kemi pranuar përgjigje deri me at datë, ne jemi detyruar të parashtrojmë këtë kërkesë për rishqyrtim, për shkak se afati i fundit për dorëzim të kërkesës për rishqyrtim ka qenë me dt.15.04.2025.
Tek kapaciteti teknik dhe profesional përkatësisht tek neni 9.1&9.2 i FDT-së është specifikuar kërkesa si në vijim:
"2. Operatori ekonomik te jete i certifikuar me ISO 9001-2015 dhe 13485-2016,45001-2018,14001-2015 (valide)", ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar "2. Duhet te ofroj dëshmi mbi certifikatat e ISO standardeve sipas kërkesës, valide".

Sa për sqarimin tuaj, më poshtë po ju njoftojmë me fushat për të cilat kërkohen certifikatat të cilat janë specifikuar në dosje të tenderit:
-ISO 9001:2015 – Kjo certifikatë lidhet me sistemin e menaxhimit të cilësisë dhe aplikohet në organizata të ndryshme që synojnë të përmirësojnë vazhdimisht cilësinë e shërbimeve apo produkteve që ofrojnë.

-ISO 13485:2016 – Kjo certifikatë ka të bëjë me sistemin e menaxhimit të cilësisë specifikisht për prodhuesit e pajisjeve mjekësore. Nuk është relevante për aktivitetin e prokurimit për furnizim me barna.

-ISO 45001:2018 – Kjo certifikatë ka të bëjë me menaxhimin e shëndetit dhe sigurisë në punë dhe nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me furnizimin me barna.

-ISO 14001:2015 – Kjo certifikatë lidhet me standardet ndërkombëtare për sistemin e menaxhimit mjedisor dhe synon minimizimin e ndikimeve negative në mjedis nga veprimtaria e një organizate.

Këto certifikata nuk kanë të bëjnë me këtë aktivitet të prokurimit, prandaj kërkojmë që të largohen nga kërkesat e dosje së tenderit sepse të njëjtat janë të panevojshme. Këto certifikata vetëm favorizojnë kompani të caktuara ndërsa në realitet nuk kanë asnjë rëndësi apo impakt në këtë tender.
Përderisa këto certifikata nuk kanë të bëjnë me natyrën e këtij tenderi atëherë duhet larguar nga dosja e tenderit sepse nuk kanë asnjë relevancë me natyrën e këtij aktiviteti të prokurimit dhe është shumë jo profesionale të kërkohen këto certifikata në këtë tender.

Andaj me qëllim të hapjes së konkurrencës kërkojmë nga OSHP-ja që të detyrojë AK-së që certifikatat e kërkuara të largohen në tërësi nga dosja e tenderit, pasi që në këtë mënyrë po diskriminohen OE të themeluar rishtazi dhe OE të tjerë të interesuar për ofertim në këtë aktivitet të prokurimit, ndërsa po favorizohen OE të caktuar të cilët posedojnë këto ISO certifikata, të cilat siç edhe e cekëm janë jo relevante me këtë aktivitet të prokurimit.

Autoriteti kontraktues ka nxjerr vendim me dt.22.04.2025 për refuzim të kërkesës për rishqyrtim, mirëpo e njëjta nuk ka dhënë asnjë arsye konkrete përse refuzohet kërkesa për rishqyrtim.
Autoriteti kontraktues arsyetohet se përmes këtyre standardeve ngritët dhe avancohet stafi profesional, prandaj nga ky arsyetim kuptohet qartë se nuk kanë asnjë rëndësi këto standarde në këtë tender.
Me këto kërkesa, jo që nuk mund të ketë trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik por do të ketë diskriminim të hapur dhe përcaktim të fituesit qysh në start të këtij aktiviteti të prokurimit, pa konkurrencë të hapur.

Paragrafi 6 i dispozitës së nenit 7 parasheh qartë : Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit". Me këto kërkesa nuk mundësohet pjesëmarrje e gjerë e operatorëve ekonomik, por në këtë mënyrë është kufizuar tej mase konkurrenca dhe këto kërkesa janë drejtpërdrejtë jo në harmoni me lëndën e prokurimit, sepse kur kufizohet konkurrenca me kërkesa të pa nevojshme atëherë edhe çmimi ofertues i operatorëve ekonomik të favorizuar automatikisht është shumë më i lartë sepse nuk kanë konkurrencë dhe faktikisht determinohet çmimi nga ana e autoritetit kontraktues në bazë të kërkesave të dosjes së tenderit.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe kundërshtimet tona që u cekën më lartë, rezulton se dosja e tenderit nuk është përpiluar në harmoni me nenin 27 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk janë marr parasysh as neni 17.17 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik ku shkruan qartë që "Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë që nuk: Kufizon konkurrencën në mesin e OE, ose Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë OE-ve".
Kërkesat që u kundërshtuan më lartë, janë shumë favorizuese/diskriminuese dhe njëkohësisht ua mbyllin dyert e ofertimit shumë kompanive me eksperiencë në këtë fushë

dhe gjithashtu këto kërkesa bien në kundërshtim edhe me nenin 25.4 të Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik, ku shkruan qartë se "Gjatë përcaktimit të kërkesave minimale për kualifikim, AK do ti kushtoj rëndësi të veçantë zhvillimit të OE dhe do të formuloj kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë që nuk përjashton OE të themeluar rishtazi të cilët posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme ekonomike, financiare dhe/ose teknike".

Me këto kërkesa, jo vetëm që nuk i është kushtuar rëndësi operatorëve ekonomik të ri, por iu është kufizuar konkurrenca edhe OE tjerë me përvojë në këtë lëmi, prandaj duhet ndryshuar/larguar kërkesat e lartcekura që të mundësohet pjesëmarrje më e gjerë e operatorëve ekonomik në këtë aktivitet të prokurimit dhe të merret parasysh edhe dispozita e lartpërmendur (25.4 të Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik). Pra, në vend se të merret parasysh edhe zhvillimi i operatorëve ekonomik të rinjë, janë diskriminuar hapur edhe operatorët ekonomik tjerë, me më shumë përvojë në këtë fushë siç është ky aktivitet i prokurimit. Pra është kufizuar konkurrenca.

Duke u bazuar në të gjitha ato kërkesa diskriminuese-favorizuese dhe në ato dëshmi të kërkuara, rezulton se këto kërkesa bijnë në kundërshtim edhe me nenin 1 të LPP-së-qëllimi i LPP-së, e ku shkruan qartë: Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në faktet që u përmenden me lartë, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që të shqyrtoj ankesën tonë dhe të nxjerr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e MESE PHARM SH.P.K
NDRYSHOHEN kërkesat, që u cekën më lartë dhe pastaj të veprohet konform nenit 53.7 të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale akoma nuk janë llogaritur sepse jemi në fazën e njoftimit për kontratë dhe fazën para ofertuese.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*

b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".

c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.

d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,

e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,

f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe

g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*